

VENDIM
Nr. 72, datë 2.2.2022

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË AGJENCISË SHTETËRORE TË
KADASTRËS, PËR VITIN 2022

(Ndryshuar me vendimin nr. 508, datë 27.7.2022)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e buxhetit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, për vitin 2022, sipas shtojcave nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2022.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

PEMA E PROGRAMIT TE ASHK-së PËR VITIN 2022

Qëllimi i Politikës së Programit

Qëllimi kryesor i Politikës së Institucionit konsiston në përmirësimin e dhënies së shërbimeve nepermjet përfundimit të procesit të regjistrimit fillestar në të gjithë vendin, si dhe modernizimit të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me qëllim automatizimin e shërbimeve, përditësimin e të dhënave dixhitale të karteles dhe hartës treguese të regjistrimit, duke garantuar informacionin e regjistruar mbi të gjitha pasuritë e paluajtshme në Shqipëri, nëpërmjet një sistemi të sigurt, efikas, bashkëkohor të regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme si dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. ASHK ka për mision të zbatojë politikën sektoriale në fushën e legalizimit të ndërtimeve pa leje, rregullimit të raporteve të pronësisë mbi truallin dhe zhvillimit urban të territoreve me ndërtime të legalizuara. ASHK, do të vazhdojë të kryejë detyrat dhe të ushtrojë përgjegjësitë e përcaktuara në përputhje me Ligjin Nr.111/2018, "Për kadastrën", i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi. ASHK ka për qëllim gjithashtu të kryejë inventarizimin e plotë të pronave shtetërore

OBJEKTIVAT


OBJEKTIVI 1: Dixhitalizimi i plotë i kartelave të pasurive të paluajtshme, regjistrimi fillestar i pasurive të paluajtshme dhe Përmirësim përditësimi i të dhënave

OBJEKTIVI 2: Automatizimi i sistemit të regjistrimit dhe legalizimit të kadastrës për ASHK

OBJEKTIVI 3: Rindërtimi i infrastruktures së ASHK, rikonstruksion ndertesash, kompletimit të Drejtorive të ASHK-së me pajisje dhe orëndi të domosdoshme

OBJEKTIVI 4: Legalizimi i Ndërtimeve Informale

OBJEKTIVI 5: Inventarizimi i Pronave shtetërore



BUXHETI I AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS JANAR-DHJETOR 2022

I RISHIKUAR

(ndryshuar me vendimin nr. 508, datë 27.7.2022)

Në 000/lekë

Përshkrimi	Buxheti janar–dhjetor 2022	
	Të ardhura	Shpenzime
	(1)	(2)
Të ardhura nga shërbimet +parcëla ndërtimore	6,121,571	
Fonde të akorduara nga buxheti i shtetit	652,000	
Shpenzime personeli		2,315,190
Shpenzime korrente		720,000
Transferta për Qendrën e Kadastrës Digjitale		652,000
Shpenzime kapitale		1,789,662
Fondi rezervë		104,700
Total	6,773,571	5,581,552
Teprica (1)-(2)		1,192,019

BUXHETI I AGJENCISË SHETETËRORE TË KADASTRËS JANAR-DHJETOR 2022

I RISHIKUAR

(ndryshuar me vendimin nr. 508, datë 27.7.2022)

N r.	Emërtimi	Buxheti janar–dhjetor 2022 (i rishikuar)
I	TOTALI I TË ARDHURAVE	6,773,571
1	Të ardhura nga shërbimet	1,800,000
2	Të ardhura nga transferimi i parcelës ndërtimore	300,000
3	Të ardhura të tjera	280,000
4	Fonde që trashëgohen nga viti 2021	3,741,571
5	Fonde të akorduara nga buxheti i shtetit	652,000
II	TOTALI I SHPENZIMEVE	5,581,552
1	Shpenzime personeli	2,315,190
1	Paga për punonjësit sipas strukturës organike të propozuar	1,348,509
2	Kontribute për sigurime shoqërore për punonjësit në organikë	224,596
3	Paga për punonjësit me kontratë të propozuar	578,114
4	Kontribute për sigurime shoqërore për punonjësit me kontratë	96,545
5	Fondi i veçantë i pagave	67,425

2	Shpenzime operative	720,000
1	Shpenzime për mallra dhe shërbime	570,000
2	Shpenzime të planifikuara për gjyqin e arbitrazhit	150,000
3	Transferta	652,000
1	Transfertë për Qendrën e Kadastrës Digjitale	652,000
4	Shpenzime kapitale	1,789,662
	Investime kapitale të patrupëzuara	469,111
1	Shpenzime për investime të patrupëzuara	469,111
	Investime kapitale të trupëzuara(rikonstrukcion +infrastrukturë IT)	1,320,551
1	Rikonstrukcione (drejtoritë vendore të ASHK-së Tiranë + Vlorë + Kukës etj.)	940,551
2	Infrastrukturë e sistemeve të IT-së + blerje pajisjesh dhe orendi	380,000
5	Fondi rezervë	104,700
1	Fondi rezervë	104,700
	TË ARDHURA (-) SHPENZIME	1,192,019